



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR NXJERRJEN E REZULTATIT TË VOTIMIT PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË
BASHKISË KAMËZ, QARKU TIRANË, NË ZGJEDHJET VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR
2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 06.07.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kamëz, Qarku Tiranë, në zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE:

Neni 21, pika 7, neni 23, pika 1, germa "a", neni 123, neni 166, pika 1 të ligjit Nr.10019 datë 29.12.2009 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Zona Zgjedhore Bashkia Kamëz territori i saj është i ndarë në 2 ZAZ. Në këtë rast KQZ-ja verifikon dhe nxjerr rezultatin për zonën zgjedhore, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

Në përfundim të procesit të dorëzimit të Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve dhe Tabelave të Rezultateve për çdo qendër votimi për Kryetarin e Bashkisë Kamëz nga të 2 KZAZ-të e kësaj bashkie, KQZ, nxjerr rezultatin për këtë zonë zgjedhore, duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit.



Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kamëz, u krahasuan Tabelat e Rezultatit për kandidatët për kryetar të qendrave të votimit të këtyre KZAZ-ve, të plotësuara nga Grupet e Numërimit me Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit të miratuara nga KZAZ nr.27 dhe KZAZ nr.28, dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik, rezultoi se:

- Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të miratuara nga KZAZ nr.27 dhe KZAZ nr.28 , përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të QV-ve që kanë këto ZAZ.
- Nga krahasimi i tabelave të rezultatit për çdo qendër votimi me tabelat përmbledhëse të rezultatit të ZAZ-së përkatëse dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik, u vërejtën mospërputhjet e shifrave si më poshtë:

KZAZ 28 BASHKIA KAMËZ PËR KRYETAR

Qv 20442

QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë				
		GN	TPR	SISTEMI
Numri Zgjedhësve që kanë votuar	gjithsej	72	122	72
	femra	39	0	39
Fletë votimi të papërdorura		732	603	732
Fletë votimi të dëmtuara		1	0	1
Flete votimi të gjetura ne kuti		72	122	72
Vota të pavlefshme		3	13	3
Vota të vlefshme		69	109	69
Fletë të hedhura gabim		0	0	0
Kandidatët për Kryetar (emër, atësia, mbiemri)				
RAKIP BAJRAM SULI		68	99	68
YLBER RAMIZ GJETA		1	10	1

Nr.	QV me probleme		GN	TPR	SISTEMI I
1	2043/1	Flete votimi të papërdorura	655	655	55
2	2047/1	Flete votimi të papërdorura	878	78	878
3	2051	Flete votimi të papërdorura	613	13	613



KQZ do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kamëz, Qarku Tiranë, me shifrat e korigjuara, mbështetur në origjinalet e tabelave të rezultateve të çdo qendre votimi të kësaj bashkie, të plotësuar nga grupi i numërimit të votave, si dhe të shpall fitues kandidatin për Kryetar Bashkia Kamëz.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 21, pika 7, neni 23, pika 1, germa "a" nenin 123 dhe nenit 166, pika 1, të ligjit Nr.10019 datë 29.12.2009 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kamëz, Qarku Tiranë, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të shpallë fitues për Kryetar të Bashkisë Kamëz z. Rakip Bajram Suli, të propozuar nga koalicioni Aleanca për Shqipërinë Europiane.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

